



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 11.03.2014
Nr. 0204-548

PËR: **Sokol Bashota**, Kryetar i Komunës së Klinës
Haxhi Ibishi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS Nr.06 -2052/2014 të pranuar më datën 07.04.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr.06-2052/2014 të miratuar me datën 28.03.2014 nga Kuvendi i Komunës së Klinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- Vendim për shpallje të konkursit publik për anëtarësimin në Komitete Konsultative në Komunën e Klinës dhe themelimi i Panelit intervistues për përzgjedhjen e anëtarëve të këtyre dy Komiteteve

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 11.03.2014
br.0204-548

Za: Sokol Bashota, Gradonačelnik opštine Klina
Haxhi Ibishi, Predsedavajući Skupštine opštine Klina

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skuptine opštine Klina br.06 -2052/2014 primljeno
dana 07.04.2014

Poštovani ,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu njenih nadležnosti i odgovornosti definisano članom 81.4 zakona o lokalnoj samoupravi , kao i uredbe br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva dodatak XII, nakon razmatranja odluke br.06-2052/2014 odobreno dana 28.03.2014 od strane Skupštine opštine Klina , Potvrđuje zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skadu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi

- Odluka o objavljivanju javnog konkursa za učlanjenje na konsultativnom savetu Odbora kao i osnivanju panela za intervjuisanje za izbor članova ovih dva Odbora .

Sa poštovanjem ,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, nenit 4 dhe 6 deri 10 të Udhëzimit Administrativ, nr. 2008/10, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 3,4,5 dhe 6 të Rregullores për Komitete Konsultative të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të rregullt për vitin 2014, të mbajtur më 28.03.2014, mori këtë:

VENDIM

Për

Shpallje të Konkursit publik për anëtarësimin në Komitete Konsultative në Komunën e Klinës dhe themelimi i Panelit intervistues për përzgjedhjen e anëtarëve të këtyre dy komiteteve

I

Miratohet Vendimi për shpallje të Konkursit publik për anëtarësimin në Komitete Konsultative në Komunën e Klinës dhe themelimi i Panelit Intervistues.

II

Komitetet Konsultative kanë nga 5 (pesë) anëtarë.
Anëtarët e Komiteteve Konsultative janë qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe njohës të fushave përkatëse.

III

Përfaqësimi gjinor në Komitetet Konsultative duhet të jetë në kuotën e 30%, duke përfshirë pjesëtar të popullsisë jo shumicë, në proporcion të përfaqësimit të tyre në Komunë.

IV

Anëtarë të Komiteteve Konsultative mund të shërbejnë më së shumti për dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

V

Mandati i parë i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 3 trevjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet në çdo vit.

Konkursi si në pikën 1 të këtij Vendimi shpallet për dy Komitete Konsultative:

1. Komitetin për Çështje Emergjente dhe,
2. Komitetin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.

VI

Kushtet, kriteret, mandati dhe afati për anëtarësim dhe procedura e konkurrimit dhe punës së panelit intervistues parashihen në konkurs konform dispozitave ligjore në fuqi dhe Udhëzimit Administrativ 2008/10.

VII

Kuvendi i Komunës themelon Panelin përzgjedhës, i cili duhet të ketë në përbërje anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe të shoqërisë civile:

1. Rasim Millaku (KK)
2. Enver Gashi (KK)
3. Agron Bacaj (KK)
4. Tahire Gashi (OJQ)
5. Binak Syla (qytetar)

Paneli intervistues ka për detyrë t'i propozojë Kuvendit listën e ngushtë për anëtarë të Komiteteve Konsultative.

VIII

Komuna është e obliguar të ofrojë në dispozicion mjetet e nevojshme në mënyrë që komitetet të kenë mundësi të kryejn punën e vet në mënyrë efektive.

IX

Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal të Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-107/2014
Klinë, më 07/04, 2014



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi